



Pranuar / Dorezuar Punë/Prudato Received/Delivety	26.01.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra e Prilog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SKIMSHQ	968/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1159/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1159/2022 të datës 13.12.2022 të parashtruar nga ankuesja _____, me adresë: Bregu i Diellit, _____, Prishtinë, kundër organit të punësimit, Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e jashtafatshme ankesa A.nr.1159/2022 e datës 13.12.2022 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____, nëpunëse civil në Ministrinë e Ekonomisë, më datë 13.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7962 të regjistruar me shenjen A.nr.1159/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 30.12.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Ekonomisë, ndërsa me datë 18.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7962/2022 të datës 13.12.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 13.01.2022 dërguar nga _____

DMZP për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur të e-mailit të datës 22.12.2021; E-mailin e datës 20.01.2022 dërguar nga ankuesja për me korrespondencën e e-mailit të bashkangjitur të datës 19.01.2021; E-mailin e datës 28.02.2022 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 09.02.2022 dërguar nga për ankuesen; E-mailin e datës 16.06.2022 dërguar nga ankuesja për ; E-mailin e datës 16.06.2022 dërguar nga për ankuesen; E-mailin e datës 16.06.2022 dërguar nga ankuesja për . me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 08.09.2022 dërguar nga ankuesja për F.K; E-mailin e datës 10.10.2022 dërguar nga ankuesja për Kërkesën e ankueses të datës 28.10.2022 me numër prot:2609; Vendimin për refuzimin e aplikimit i datës 18.05.2022; Vendimin për refuzimin e ankesës i datës 25.05.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 i datës 28.12.2018; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 12.12.2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 maj/2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 30.12.200; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për muajt (janar-shkurt-mars) të vitit 2021 i datës 20.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 18.01.2022; Vendimin e datës 14.04.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 03.09.2012 me përshkrimin e detyrave të punës; E-mailin e datës 10.10.2022 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 02.03.2022 dërguar nga për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 09.09.2022 dërguar nga . për E-mailin e datës 17.01.2023 dërguar nga

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.1159/2022 e datës 13.12.2022, e parashtruar nga ankuesja Aida Lolluni është e *jashtafatshme*, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Aktin e Emërimit të datës 03.09.2012 rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës *Auditor i Brendshëm* pranë Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa përmes Vendimit me numër:965 të datës 14.04.2021 nga Sekretari i Përgjithshëm e njëjta është caktuar Zëvendësuese e Udhëheqëses së Divizionit të Auditimit në Ministrinë e Ekonomisë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit bazuar në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 20.01.2022 ka gjetur se ankuesja është vlerësuar vetëm për periudhën nga datat 01 janar deri me datë 30 mars 2021, pasi që nga muaji prill me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm është caktuar në cilësi të zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit të Auditimit të Ministrisë së Ekonomisë, dhe se për mbikëqyrës të drejtpërdrejtë ka pas Ministrin e Ministrisë së Ekonomisë, e që sipas shkresave të lëndës rezulton se nuk e ka vlerësuar ankuesen për periudhën e mbetur të vitit, gjegjësisht për periudhën prill-dhjetor 2021.

Kolegji i Këshillit duke i referuar provave të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve e Ministrisë së Ekonomisë me datë 22.12.2021 u ka dërguar e-mail zyrtarëve të ministrisë duke përfshi edhe ankuesen, duke i njoftuar lidhur me procedurën e vlerësimit, afatin kohor se kur duhet realizuar vlerësimi sikurse edhe detaje të tjera lidhur me mënyrën e realizimit nëpërmes sistemit elektronik, dhe po ashtu me datë 13.01.2022 e njëjta ua ka përcjellë edhe linkun e SIMBNJ-së përmes të cilit mund të realizohet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë, sikurse edhe të verifikohet fakti nëse nëpunësit janë vlerësuar nga eprorët apo udhëheqësit e drejtpërdrejtë, në rast konkret edhe ankuesja.

Po ashtu, Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 09.02.2022 e kishte njoftuar ankuesen se vlerësimi ndaj të njëjtës nuk është bërë ende lidhur me periudhën kohore që është caktuar në Zëvendësuese e Udhëheqëses së Divizionit të Auditimit në Ministrinë e Ekonomisë, ndërsa me datë 28.02.2022 ankuesja kërkesën për vlerësim e ka përcjellë përmes e-mailit tek shefi i kabinetit të ministres, dhe tek pas një periudhe prej më shumë se katër (4) muajsh kur kishte kaluar afati ligjor, ankuesja i drejtohet ministrisë me datë 16.06.2022 me kërkesën për vlerësim të rezultateve të punës për periudhën kohore prill-dhjetor të vitit 2021, kërkesë të cilin ankuesja e ka përsërit në cilës të njoftimit edhe tek Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore përmes e-mailit të datës 08.09.2022, ndërsa Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore ia ka rikujtuar ankueses se vlerësimi i saj bëhet nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, në rastin konkret ministrja e Ministrisë së Ekonomisë, njëkohësisht duke ia përkujtuar sikurse edhe në e-mailin paraprak të datës 22.12.2021 se vlerësimi i rezultateve të punës sipas Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike bëhet ndërmjet periudhës kohore nga data 01 deri me datë 31 janar, për vitin paraprak.

Ankuesja, sërish përmes e-mailit të datës 10.10.2022 i drejtohet ministres me kërkesën për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 (periudhën prill-dhjetor) duke ia bashkangjitur edhe formularët e vlerësimit të rezultateve të punës sikurse edhe objektivat e punës për vitin 2021, ndërsa në mungesë të përgjigjes, e njëjta me datë 28.10.2022 e përsërit kërkesën me numër protokoll:2609 për vlerësimin e rezultateve të punës, ndërsa me datë 13.12.2023 për shkak të heshtjes administrative në kërkesën e saj, ankuesja ka parashtruar ankesë në këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sjell në vëmendje faktin se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil sipas këtij ligji.

Me tutje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 43 paragrafi 1 përcaktohet se: *"1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues"*.

Andaj, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 125 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"), si dhe nenit 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, dhe paragrafin 4 ku përcaktohet se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", dhe si rrjedhojë duke ju referuar këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e*



parashtruar me datë 26.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e jashtafatshme, sepse vlerësimi i rezultateve të punës bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues, që nënkupton se ankuesja ka mundur të parashtroj ankesë ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 për përfundimin e procedurës administrative, por në rastin konkret e njëjta nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë brenda afateve të përcaktuara kohore.

Për me tepër ankuesja me datë 22.12.2021 ka qenë e njoftuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 dhe afateve kohore të cilat duhet të respektohen sikurse përcaktohen me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Po ashtu, ankuesja ka qenë e njoftuar lidhur me vonesat kohore të realizimit të vlerësimit të rezultateve të punës, apo heshtjes së udhëheqëses së saj të drejtpërdrejtë lidhur me këtë çështje, njoftime të cilat i ka pranuar nga kabineti i ministres përmes.

Andaj, për sa me sipër është konstaton se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1159/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.